

FATMIR AGALLIU

VËZHGIME MBI KUPTIMET E DISA TRAJTAVE KOHORE

Shqipja është një gjuhë me një sistem shumë të pasur formash për shprehjen e raporteve kohore. Folësit e gjuhës mund të përdorin shpesh njërën formë për tjetrën për të shprehur kuptime të ndryshme nga ato që janë tipike për atë formë. Në literaturën tonë gjuhësore kuptimet e kohëve të foljes janë studjuar në mënyrë të pamjaftueshme. E meta themelore në këtë pikë neve na duket se është studimi dhe analiza e tyre në mënyrë të shkëputur.

Qëllimi i këtij artikulli nuk është të rrahë gjithë anët e problemit, sepse kjo do të ishte e pamundur për vetë caqet e këtij parashtrimi, por të bëjë një sprovë të parë në studimin e semantikës së kohëve të foljes me anë të ballafaqimit të trajtave të tyre gramatikore. Këtu ne do të ndihmohemi edhe nga të dhënat që dalin nga transformimi i shprehjeve që mund të zëvendësohen reciprokisht, duke ndryshuar pikëreferimin kohor.

Në analizën e përmbajtjes kuptimore të formave gramatikore, për të arritur në përfundime shkencërisht të sakta, marrja parasysh e ngjashmërisë strukturale ose e identitetit të një elementi lingistik bëhet një nevojë e domosdoshme. Prandaj për ne tingëllojnë mjaft bindëse fjalët e shprehura nga Smirnicksi: «...identiteti ose ngjashmëria e jashtme, si rregull, në gjuhë është shprehje e një identiteti ose ngjashmërie të brendshme, pa këtë ligjshmëri gjuha nuk mund të funksionojë si mjet komunikimi»¹.

Kështu, p.sh., kohët e përbëra të foljes kanë një ndërtim analog; ato i dallon prej njëra-tjetrës vetëm koha e foljes ndihmëse. Prandaj edhe në kuptimin kohor themelor, siç do të sqarohet më poshtë, ato bashkohen nga një karakteristikë e përgjithshme. Po ky shënim mund të bëhet edhe për format foljore që formohen prej kohëve të ndryshme të mënyrës lidhore me pjesëzën *do* përpara, të cilat nuk mund të ndahen dot prej njëra-tjetrës dhe formojnë një sistem të caktuar, atë të kohës së ardhshme.

Si prej pikëpamjes së kuptimit, ashtu edhe prej pikëpamjes trajtë-formuese, brenda mënyrës dëftore duhen dalluar katër forma kohore themelore — *shkoj*, *shkoja*, *shkova*, *do të shkoj*. Ndërkaq, dallimi midis *shkoja* dhe *shkova* nuk është me karakter kohor, por aspektiv. Mbi bazën e këtyre katër formave të foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* formohen katër format e së kryerës (perfektit) *kam* shkuar (*jam* larë), *kisha* shkuar (*isha* larë), *pata* shkuar (*qeshë* larë), *do të kem* shkuar (*do të*

1) Smirnicksij, A. I., *Morfologjia anglijskogo jazyka*, Moskva, 1959, fq. 299.

jem larë)². Ne do t'i quajmë këto trajta si forma të perfektit, sipas Smirnickit, duke u nisur nga ndërtimi i tyre analog me perfektin (ndryshon vetëm koha e foljes ndihmëse) dhe nga kuptimi i tyre i përgjithshëm i të treguarit të një veprimi të përparshëm, që kryhet para një veprimi tjetër. Ndërkaq ndërtimet *kisha shkuar* dhe *pata shkuar* mund të trajtohen edhe si dy variante të një trajte kohore të vetme, të më se të kryerës³.

Emërtimi i trajtës së formuar nga aoristi i foljes ndihmëse si aorist i dytë⁴ nuk i përgjigjet kuptimit të saj të zakonshëm. Gjithashtu ai bie në kundërshtim me emërtimet e dy formave të tjera me ndërtim analog — së kryerës dhe më se të kryerës, të cilat po për ato arsye nuk mund të quhen përkatësisht e tanishme e dytë dhe e pakryer e dytë.

Shqyrtimi nga ana e kuptimit i formave të së kryerës, sidomos i më se të kryerës, do të përbëjë përmbajtjen themelore të këtij artikulli.

Një vështrim i tillë i krahasuar jemi të mendjes se duhet bërë edhe midis së tanishmes dhe së pakryerës. Kjo për ne ka rëndësi se ndihmon për sqarimin e natyrës së pluskuamperfektit. Pa u marrë hollësisht me këtë problem, që kërkon një shqyrtim të veçantë, ne po pohojmë këtu se na duket mjaft bindës të cilësuarit e së pakryerës si e tanishme brenda së shkuarës. Gjuha shqipe jep nga ana e saj material interesant në të mirë të një kuptimi të tillë.

Me të dyja këto kohë përdoret pjesëza **po**, e cila ka po atë vlerë si në të tanishmen ashtu edhe në të pakryerën. Sipas nesh kjo pjesëzë shërben për ta lokalizuar veprimin që shpreh folja në momentin e ligjëritimit ose në një moment tjetër para këtij, që përbën fondin e tregimit ose të përshkrimit. Kur janë të përdorura pa këtë pjesëzë foljet në këto dy kohë tregojnë zakonisht veprime që s'kufizohen në kohë, pra zgjaten pa cak, përsëriten herë pas here dhe vazhdojnë s'dihet sa. Analogjia kuptimore që vihet re midis këtyre dy llojeve të «prezentit», zbulohet edhe midis dy llojeve të perfektit, perfektit të tanishëm dhe atij të shkuar (pluskuamperfektit),* të cilët janë formuar, i pari mbi bazën e së tanishmes dhe i dyti mbi atë të së pakryerës së foljes ndihmëse. Prandaj pluskuamperfekti (më se e kryera) nuk duhet studjuar ndarë nga perfektu. Ne miratojmë plotësisht idenë e shprehur nga Smirnicki «Uniformiteti i strukturës së jashtme të kohës së tanishme të perfektit dhe të formave të tjera analitike të perfektit, kërkon që gjithë këto forma të vështrohen si një sistem unik»⁵.

Kuptimi i përgjithshëm i formave të së kryerës (perfektit) është kryerja e një veprimi para një kohe të caktuar, e cila në fjali shpesh paraqitet me tregues të ndryshëm kohorë — plotësorë kohe dhe fjali kohore. Me këtë kohë ato lidhen qoftë nëpërmjet pasojave, qoftë nëpërmjet këndit nga i cili vështrohen. Në anën tjetër, kuptimi i kohës së kryer të thjeshtë ose të pakryer është kryerja e një veprimi para momentit të ligjëritimit, me të cilin ato lidhen drejtpërdrejt.

2) Nga kjo pikëpamje nuk duket bindës pohimi i Sh. Demirajt sipas të cilit e ardhmja e përparme formohet duke u paravënë pjesëzën e ngurosor *do* formave gramatikore të foljes themelore në kohën e kryer të mënyrës lidhore (Morfollogji e gjuhës së sotme shqipe, pjesa II, Tiranë, 1963, fq. 196).

3) Për këtë shih edhe Norbert Boretzky, *Perfekt und Plusquamperfekt in einem nordostalbanischen Dialekt*, në «Beiträge zur Sudesteuropa-Forschung», 1966, fq. 91.

4) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, fq. 115; Sh. Demiraj, *vepër e cituar*, fq. 193.

5) Smirnicki, *vepër e cituar*, fq. 299.

Për më se të kryerën dhe për të ardhshmen e përparshme (perfektin e futurit) kjo kohë është e përcaktuar mirë dhe, sipas rastit, jepet me tregues të ndryshëm kohorë. Për perfektin, përkundrazi, puna qëndron pak më ndryshe, sepse koha e tanishme, mbi bazën e së cilës formohet perfektin, është përgjithësisht koha që përputhet me momentin e një ligjërimi të caktuar, i cili shpeshherë s'është nevoja të përcaktohet me tregues kohorë, sepse këtë e bën situata e të folurit. Kjo është, pas nesh, edhe arësyeja kryesore që dallimi midis perfektit dhe aoristit, në shumë raste mezi kapet, dhe ata në të folur shpeshherë përzihen. Që të dyja këto trajta kohore kanë si pikëreferimi të drejtpërdrejtë të tanishmen dhe tregojnë një veprim që kryhet para kësaj periudhe kohe. Ndryshe qëndron puna me më se të kryerën.

Momenti ose periudha, para së cilës kryhet veprimi i shprehur nga një folje në më se të kryerën, në gjuhën shqipe mund të jepet:

1) Me anë të një ngjarjeje paraqitur nëpërmjet një fjalie kohore, kallëzuesi i së cilës mund të jetë një folje në aorist ose në të pakryerën e mënyrës *dëftore* ose *lidhore*: «Kur **arriu** Skënderbeu në Torvioll, Aidini e *kishte radhitur* ushtërinë sipas planit të betejës. (F. Noli), HeS, 38), «Kur **dul** qo, *djali kishte* ikë. (Folklori shqiptar, IV, 105). «Përpara se **të pushonte** beteja, dasma *kishte marrë* fund» (F. Noli, po aty, 46). Në prozën popullore hasen raste të shoqërimit të kësaj kohe me një prezent historik: «Del qo plaka, kur **shikon** qo, goca *kishte dalë* aty m'shkam ne po rrinte (Folklori shqiptar, IV, 105). Në këtë rast spikat në mënyrën më të dukshme kuptimi i pluskuamperfektit si kohë relative, që tregon një veprim paraardhës, që kryhet para një tjetri në kohën e shkuar.

2) Ky moment mund të jepet edhe me anë të një plotësori të kohës, shprehur zakonisht me një ndajfolje: «Franka nuk e dëgjon fare të shoqin dhe e vërteta është se kjo **kurrë s'e kishte dëgjuar**» (P. Marko, Q. i fundit, Nëndori, 1, 1960, 67), I herë **n'kohë t'përparshme** — thotë qo — na *kishte qenë* «i mbret — thotë» (Folklori shqiptar, IV, 111), «Vita **atë natë ishte bërë** e prapë fort» (J. Xoxa, L. V, II, 16). Me këtë moment kohor folja në më se të kryerën lidhet nëpërmjet pasojave. Më se e kryera e diatezës pësore — vetvetore na duket se e ka më të qartë kuptimin rezultativ dhe kjo duhet lidhur me faktin se pjesorja e shkuar e gjuhës shqipe kryesisht ka kuptim pësor. Ky kuptim shfaqet më qartë në trajtën mbiemërore të pjesores. Nga kjo pikëpamje trajtat e më se të kryerës shpeshherë paraqiten për nga kuptimi sinonimike me një konstrukt kallëzuesor të formuar nga e pakryera e foljes këpujë *jam* dhe nga pjesorja mbiemërore e foljes që shënon veprimin: «Përandoria Bizantine mezi merrte frymë. Serbia *ishte e çalur*. Bullgaria *ishte e shtypur*. Makedonia dhe Greqia veriore *ishin shkelur*». (F. Noli, po aty, fq. 11).

3) Nga materialet del se më se e kryera haset më shpesh në gjuhën letrare nëpër fjali të varura përcaktore, të lidhura me anë të një përemri ose ndajfoljeje lidhore. Në fjalinë prej nga varet fjalia përcaktore ku ndodhet folja në këtë kohë, është gjithmonë e pranishme një gjymtyrë emërore, që përfaqëson një person a send me të cilin diçka ka ndodhur, i cili i është nënshtruar një procesi, ose me të cilin lidhet në një farë mënyre veprimi a gjendja e treguar nga folja në fjalinë e varur, veprim a gjendje që kryhet para kohës së foljes në fjalinë tjetër: «...bridhte nëpër shtëpi, që të zbrazte jo vetëm **ujët**, që *kishte mbushur* në pus, po edhe barkun. (J. Xoxa, L. V, II, 91), «Dhe

duke hedhur me zor këmbët, i afrohej **vendit** ku *kishte vendosur* dengun e tij» (P. Marko, po aty, 91). «Kur u kthye Skënderbeu nga **Siria**, tek *kish vajturë* të lëftonte për turqit, dëgjoi nga goja e sulltanit vetë që i ati *kish vdekurë...*». (S. Frashëri, po aty, fq. 31).

4) Periudha kohore, para së cilës kryhet veprimi i shprehur nga folja në më se të kryerën, mund të merret vesh edhe nga konteksti, nga foljet e fjalive përpara, ose mund të nënkuptohet një plotësor kohe. Në këtë rast folja në këtë trajtë kohore gjendet e përdorur nëpër fjali të varura ose kryesore. Këto janë nga rastet më të rralla të përdorimit të kësaj kohe, por normale dhe të ndryshme. «Ana Maria *kish zbritur* gjer në rrëzë të bllokut shkëmb dhe *kish futur* në det këmbët gjer në gju. *Kishte ngritur* më lart fustanin e saj të hollë bojë blu prej mëndafshi artificial. Një xhakëtë e *kish lënë* majë shkëmbit (P. Marko, po aty, 67). Është i njohur mendimi sipas të cilit më se e kryera është një kohë relative. Duke e miratuar këtë pikëpamje, duam të vëmë në dukje këtu se përdorimet e pikës 4 nuk bien ndesh me të, prandaj shembujt që jep K. Cipo⁶, duhen shpjeguar ndryshe. Kështu fjalia që jep si shembëll K. Cipo, «Gjeli *kishte hipur* në lis» mbetet barabar pa kontekstin e duhur, edhe po t'i shtohet fjalia e varur «që të flinte». Këtë punë mund ta bëjë një plotësor kohe, një fjali kohore, ose një rrethim tjetër konteksti, pa të cilin më se e kryera s'bën dot; ndryshe është puna me të kryerën, e cila mbështet në rrethanat konkrete të ligjërit, në një situatë konkrete.

Pavarësisht nga dallimet e shumta, që mund të vihen re midis së kryerës dhe më se të kryerës, të cilat e kanë burimin në faktin se e para bën pjesë në planin e së tanishmes dhe e dyta në atë të së shkuarës, gjë që shprehet me kohët e ndryshme të foljes ndihmëse, kuptimi i përgjithshëm kategorial i tyre është i njëjtë, prandaj ne mund ta konsiderojmë më se të kryerën (pluskuamperfektin) një perfekt të kohës së shkuar. Këtë na e bën të qartë edhe mundësia e transformimit të këtyre trajtave kohore në njëra-tjetrën, duke ndryshuar pikëreferimin kohor. Kështu fjalia «Vujejtjet ma tepër se koha *kishin lanë* në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta». (Q. Stafa, Q. vj., Ant. let. shqip, 1955 341) mund të transformohet në fjalinë «vujejtjet ma tepër se koha *kanë lanë* në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta».

Një transformim i tillë bëhet i domosdoshëm sa herë kthejmë një ligjeratë të drejtë në të zhdrejtë. Duke marrë si pikëreferim kohor një moment të kohës së shkuar, e tanishmja dhe e kryera e ligjeratës së drejtë kthehen në të zhdrejtën përkatësisht në të pakryerën dhe në më se të kryerën. Në përdorimin praktik të këtyre dy kohëve ajo që të bie më tepër në sy, është fakti se më se e kryera haset kryesisht nëpër tregime për ngjarje të kohës së kaluar, ndërsa perfektin më shpesh nëpër dialogje, ose përgjithësisht atëhere kur për ngjarje dhe fakte të kohës së kaluar flitet nga pikëpamja e së tanishmes, në lidhje me të. Megjithatë, sikurse dihet e kryera mund të përdoret edhe si kohë historike, sidomos në të folmet e gegërishtes veriore: «M'atë kohë Varoshi ka pa qenë aq i madh sa ni funvaroshas e ni krevaroshas *janë ba* na 70 vjeç, ene *s'janë pa* asnjherë me shoshojnë, qaq kasaba e madhe ishte Varoshi» (K.P.H., 49).

Në mënyra të ndryshme është trajtuar në gramatikat e gjuhës shqipe edhe e ashtuquajtura kohë e kryer e tejskhuar, ose sipas terminolo-

6) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, fq. 115.

gjisë që kanë përdorur disa gjuhëtarë, aoristi i dytë. Vrojtimit mbi materialet e gjuhës së sotme na tregojnë se kjo trajtë kohore është pak e përdorshme, sidomos në toskërishten. Më dendur haset trajta pësorevetvore, ndërsa trajta veprare tek ndonjë autor nuk gjendet fare. Ndonjë e folur (sipas një kumtimi gojor të E. Çabejt, ajo e Gjirokastroës) e përdor më se të kryerën me ndihmësen *qe*, sepse mungon trajta *ishte*. Kështu mund të shpjegohet edhe ky përdorim: «Surati engjëllor i Perikliut *qe ngrysur* dhe kish zënë një cipë errësirë, sa që i kalli datën të zotit të shtëpisë, i cili, me zemër në dorë, thoshte me vete duke bërë lanet të birin» (N. Sinaeri, Ajo që ndodhi në darkën e psalltit, Nëndor, 1, 1960, 113).

Për të përcaktuar dallimet e së kryerës së tejshkuar nga më se e kryera duhen studime të mëtejshme. Ne po shtojmë këtu se kjo trajtë përdoret shpesh nga autorët për variacion stilistik: «Valët *patën hyrë* nën rrogos, kishin përshkuar kashtën, qilimin me thekë, ishin pirë nga rrobat e trupit dhe i kishin hyrë në mish» (J. Xoxa, po aty, 102). Kuptimi kohor themelor i kësaj trajte është i barabartë me atë të formave të tjera të perfektit, d.m.th. edhe ajo tregon një veprim paraardhës: «I lindi ksaj⁷ i djalë e i gocë me yll në ballë, sikur *pat thanë*» (Folklor shqiptar, IV, 112).

Këtu mund të pritej një ndryshim në pikëpamje të aspektit, por me që foljet ndihmëse nuk lozin rol vendimtar në përcaktimin e ngjyrës aspektive të trajtave të përbëra, ato mund të vështrohen edhe si dy variante të një trajte kohore të vetme. Që të mund të ndriçojmë në mënyrë më të plotë disa pika pak të sqaruara të sistemit të formave të perfektit, e quajmë të nevojshme të ndalemi edhe në trajtën kohore të së ardhshmes së përparme. Në gramatikat shkollore të shqipes është dhënë vetëm kuptimi i parë i kësaj kohe — një veprim që do të kryhet para një tjetri në kohën e ardhshme. K. Cipo në Sintaksën dhe Shaban Demiraj në dispensën e morfologjisë⁷ japin edhe një kuptim të dytë të kësaj kohe, i cili paraqitet si më kryesori dhe prurë thuatj i vetmi përdorim i saj. Nga vëzhgimet e bëra ne kemi prurë bindjen se në kuptimin e parë kjo trajtë përdoret shumë rrallë dhe është zëvendësuar nga perfekt i mënyrës lidhore. Shënojmë këtu kalfimthi se e tanishmja dhe perfekt i mënyrës lidhore nëpër fjali të varura kanë vlera kohore të barabarta me ato të së ardhmes. Duke ruajtur kuptimin kohor themelor — të tregojë një veprim paraardhës, e ardhshmja e përparme është zhvendosur nga një perfekt i kohës së ardhshme në një perfekt të së tanishmes dhe është veshur me një modalitet të theksuar mundësie (në kuptimin e probabilitetit): «*Malua u vonua të kthehet. Do t'i ketë ngjarë* ndonjë e papritur» (S. Andoni, Shënime të shkruara natën, Nëndori, 5, 1963, 27). Një kuptim i tillë haset edhe në trajtën kohore të së ardhshmes dhe në trajtën e së ardhshmes identike me kushtoren: «*Do të ketë* ndonjë hall ky, se fashistët e ligj s'janë mendjelehtë të ngulin këmbë për të tilla budallallëqe» (P. Marko, po aty, fq. 57), «*S'kemi t'ju japim gjë, më foli një që do të ishte komandanti i tyre*» (P. Marko, po aty, 91), por kufizohet vetëm tek foljet *kam* e *jam*. Shtrirja e përdorimit edhe me folje të tjera në format e së ardhshmes së përbërë, në krahasim me kufizimin e tij vetëm në foljet *kam* e *jam* në format e së ardhmes së thjeshtë, mendoj se duhet shpjeguar me këtë që foljet ndihmëse *kam* e *jam*

7) K. Cipo, *Sintaksa*, 1952, fq. 43; Sh. Demiraj, *vepër e cituar*, fq. 207.

në kohët e përbëra ruajnë vlera kuptimore, që i kanë kur përdoren si fjalë më vehte. Procesin e kalimit ne e përfytyrojmë në këtë mënyrë: do të ketë (ndonjë hall) në: do të ketë pasur (ndonjë hall) dhe prej këtej në: do t'i ketë ngjarë (ndonjë gjë). Sidoqoftë çështja është e hapur. Edhe mendimet e tjera duhen marrë në konsideratë⁸, pra duhet parë edhe ana tjetër, ajo e mundësisë së vështrimit të fjalëzës do si një folje modale me kuptim leksikor të pashlyer, paravënë trajtave të mënyrës lidhore, sadoqë autori i këtij artikulli nuk është i bindur për këtë gjë.

Ky përdorim përfshin gjithë sistemin e kohës së ardhshme në shqipen dhe kjo provon, veç të tjerave, se trajtat e mënyrës kushtore nuk mund të ndahen dot nga ato të së ardhshmes së dëftores, bashkë me të cilat formojnë një sistem si për nga struktura e formimit, ashtu edhe për nga vlerat kuptimore që kanë ose fitojnë me kohë.

«Dreka dukej se do të kish filluar që kur, sepse zërat e atyre që këndonin, e kishin arritur kupën e qiellit» (N. Sinaeri, po aty, 192). Neve na duket se ka pasur pikërisht të drejtë Sami Frashëri, i cili të dy trajtat kohore do të huanja dhe do të kisha huarë i quan përkatësisht *I-pritm'i parthim* dhe *I-pritm'i mëparthim* dhe i përfshin brenda mënyrës dëftore⁹. Kalimi i kuptimit, për të cilin u fol më sipër, në shqipen duhet të jetë i ri dhe do të jetë bërë i mundshëm nga fakti se e ardhmja, gjithë duke u përfshirë në format e mënyrës dëftore, tregon një fakt që as është realizuar, as po realizohet në të vërtetë, por pritet të realizohet. Por ajo që pritet të ndodhë, nuk është krejt e sigurtë.

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LE SENS DE CERTAINES FORMES TEMPORELLES

L'auteur a fait un essai pour étudier plus à fond les temps du verbe, au moyen de la comparaison de leurs formes grammaticales. Il utilise aussi les données de la transformation des expressions pouvant être substituées mutuellement, en modifiant le point temporel de référence. Son point de départ est pris de Smirniński: «...l'identité ou la ressemblance externe est ordinairement, dans une langue, l'expression d'une identité ou ressemblance interne; sans cette régularité, la langue ne peut pas fonctionner comme moyen de communication».

En partant de leur construction analogue avec le parfait, de leur sens général à indiquer une action antérieure, effectuée avant une autre action, l'auteur considère les quatre formes temporelles composées: kam shkuar, kisha shkuar, pata shkuar, do të kem shkuar, des formes de parfait.

L'essentiel de la communication est formée par l'examen comparé, au point de vue du sens, des formes du parfait, notamment du plus-que-parfait, en vue de mettre au clair quelques points insuffisamment ou point élucidés du système des formes du parfait dans la linguistique al-

8) Për një kuptim të tillë të fjalëzës do ka shkruar edhe Xh. Lloshi, St. Fil. 4 1966, f. 188.

9) Sami Frashëri. *Shkronjëtoe e gjuhës shqipe*, Bukuresht, 1886, fq. 87-88.

banaise. On sait que le sens général des formes du parfait est l'accomplissement d'une action, antérieurement à un temps donné, accomplissement auquel ces formes sont rattachées soit au moyen des conséquences, soit à travers le point de vue où l'on se place pour envisager la question. En ce qui concerne le plus-que-parfait en albanais, il est parfaitement déterminé et il est donné, d'après le cas, de façons différentes.

L'instant ou la période antérieurement à laquelle a lieu l'action exprimée par un verbe au plus-que-parfait peuvent être exprimés:

1) Au moyen d'un événement présenté par une proposition temporelle, dont le prédicat peut être un verbe à l'aoriste ou à l'imparfait des modes conjonctif ou indicatif. Dans la prose populaire on a des cas d'association de ce temps à un présent historique également: «Kur arriu Skënderbeu në Torvioll, Aidini e kishte radhitur ushtrinë sipas planit të betejës» (F. Noli); «Përpara se të pushonte beteja, drama kishte marrë fund» (F. Noli).

2) Ce moment peut être donné aussi au moyen d'un complément de temps, exprimé habituellement par un adverbe. Le plus-que-parfait est rattaché ainsi à ce moment au moyen des conséquences: «Franka nuk e dëgjoï fare të shoqin dhe e vërteta është se kjo kurrë s'e kishte dëgjuar». (P. Marko).

L'auteur croit que le plus-que-parfait de la voix médio-passive a un sens résultatif plus accentué. A ce point de vue, les formes du plus-que-parfait se présentent souvent, au point de vue sémantique, comme synonymes d'une construction de prédicat formé par l'imparfait du verbe copulatif jam et par le participe adjectival du verbe énonçant l'action: «Perandoria Bizantine mezi merrte frymë... Bullgaria ishte e shtypur. Makedonia dhe Greqia veriore ishin shkelur.» (F. Noli).

L'auteur a constaté que le plus-que-parfait est rencontré souvent dans des propositions subordonnées relatives, unies au moyen d'un pronom ou d'un adverbe conjonctif: «Kur u kthye Skënderbeu nga Siria, tek kish vajtur të luftonte për turqit, dëgjoï nga goja e Sulltanit vetë që i ati kish vdekur...» (S. Frashëri).

Indépendamment des nombreuses distinctions qu'on peut remarquer entre le parfait et le plus-que-parfait, distinctions qui tirent leur source dans le fait que le premier fait partie du plan du présent et le deuxième de celui du passé, (ce qui est exprimé par les temps du verbe auxiliaire) le sens général de catégorie est identique. C'est pourquoi nous pouvons considérer aussi le plus-que-parfait de l'albanais un parfait de temps passé. Cela trouve sa consistance aussi dans la possibilité de modifier ces formes temporelles par la substitution de l'une par l'autre, en modifiant le point temporel de référence. Une telle modification devient nécessaire, toutes les fois qu'on fait tourner un discours direct en indirect.

L'auteur soutient plus loin l'affirmation connue que le passé antérieur n'a qu'un usage rare. Plus rare il est dans le dialecte tosque, même introuvable chez quelque auteur. On a plus fréquemment la forme médiopassive et cela peut être expliqué aussi par le fait désormais connu du mélange dans le langage courant, de l'aoriste ou de l'imparfait du verbe être (jam).

Maint auteur emploie cette forme temporelle pour de la variation stylistique: «Valët patën hyrë nën rrogoz, kishin përshkuar kashtën, qilimin me thekë, ishin pirë nga rrobat e trupit dhe i kishin hyrë në mish.» (J. Xoxa).

Le sens temporel fondamental de cette forme est égal à celui d'un plus-que-parfait, c'est-à-dire qu'il indique une action qui précède une autre dans le passé: «I dhq Zoti ksaj 'i djalë e 'i gocë me yll në ballë, sikur pat thanë» (langage courant).

Afin de pouvoir éclaircir plus à fond quelques questions encore non traitées amplement du système des formes du parfait, l'auteur considère nécessaire de s'arrêter aussi sur la forme temporelle du futur antérieur.

Des observations qu'il a faites, il a eu la conviction que dans le premier sens cette forme n'est usitée que très rarement et qu'on lui a substitué le parfait du conjonctif. Le présent et l'imparfait de ce mode en albanais, dans des propositions subordonnées, ont des valeurs temporelles, égales à celles du futur. En gardant le sens temporel fondamental — énoncer une action antérieure, — le futur antérieur s'est déplacé d'un parfait du futur en un parfait du présent et s'est revêtu d'une modalité accentuée de possibilité (dans le sens du probable): «Malua u vonua të kthehet. Do t'i ketë ngjarë ndonjë e papritur.» (S. Andoni).

Un tel sens est rencontré aussi dans la forme temporelle du futur: «Do të ketë ndonjë hall ky, se fashistët e ligj s'janë mendjelehtë...» (P. Marko), mais il se circonscrit aux seuls verbes avoir (kam) et être (jam). L'extension de cet usage sur d'autres verbes encore sous les formes composées du futur, par rapport à sa limitation aux seuls verbes kam et jam sous les formes du futur simple, doit être expliquée par le fait que les verbes auxiliaires kam et jam gardent, dans les temps composés, des valeurs de sens qu'ils ont déjà quand ils sont employés comme des verbes non-auxiliaires.

On doit remarquer aussi l'autre possibilité du sens de la particule do, comme un verbe modal dont les sens lexical n'est pas encore éteint, quoique l'auteur ne soit pas convaincu pour cela. Ce sens comprend tout le système du futur en albanais, y compris aussi les soidisantes formes du conditionnel. Et cela prouve, entre autres, que ces formes ne peuvent pas être séparées de celles du futur de l'indicatif, avec lesquelles elles constituent un système, aussi bien comme structure de formation que comme valeur de sens.

Il est intéressant de mentionner que Sami Frashëri, un des premiers grammairiens albanais, insère les formes temporelles du conditionnel dans l'indicatif, comme forme du futur antérieur.